Shpërthim tritoli në banesën e policit në Shkodër

10:58 30/12/2022

Nuk ka të lënduar, vetëm dëme materiale

Këto janë shenjat e shpërthimit të lëndës plasëse në portën e banesës së një efektivi policie të identifikuar si Valter Serra, në fshatin Bardhej të Shkodrës.

Ai është me detyrë punonjës i Patrullës së Përgjithshme të Komisariatit të Policisë së këtij qyteti. Ngjarja u regjistrua në orën 2 të mëngjesit të kësaj të premte dhe shpërthimi është raportuar të ketë qenë i fortë.

Si pasojë ka marrë dëmtime porta, banesa dhe makina tip "Volksvagen" e efektivit të Policisë, por fatmirësisht nuk ka pasur rrezik për familjarët.

Policia është duke hetuar për rastin dhe në hyrje dhe dalje të fshatit Bardhej ka sekuestruar kamerat e sigurisë për të bërë të mundur identifikimin e autorit.

Kjo nuk është hera e parë që në qytetin e Shkodrës në banesat e punonjësve të policisë është vendosur sasi plasëse. Gjatë 2022, në muajin qershor dhe maj, dy punonjës të tjerë të Policisë së Shkodrës kanë rënë pre e shpërthimeve me lëndë plasëse.

Tv Klan

TË NGJASHME

Trafikimi i fëmijëve, burg për 2 nga të arrestuarit

19:39 30/12/2022

Vodhën para dhe sende personale, arrestohet 17-vjeçari dhe shpallet në kërkim një tjetër

13:11 30/12/2022

U arrestua për trafik droge, burg për zyrtaren e AKSHI-t

10:46 30/12/2022

Gjykata e Korçës le në qeli Viola Sterjon

10:38 30/12/2022

Shpërthim tritoli në banesën e policit në Shkodër

09:58 30/12/2022

Erisa Fero, 28-vjeçarja që u arrestua me drogë përfundon në mediat greke...

09:48 30/12/2022

50 kriminelë shqiptarë do të kthehen në atdhe, media britanike: Do ta vuajnë dënimin në Shqipëri

09:31 30/12/2022

Video | Digjen qëllimisht makinat e një biznesmeni

07:36 30/12/2022

I vë zjarrin dyqanit dhe makinës së një personi, shpallet në kërkim 39-vjeçari

07:30 30/12/2022

© 2022 TV Klan. All Rights Reserved.